



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
Këshilli Drejtues

V E N D I M

Nr.47, datë 05.07.2018

PËR

MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË TENDERIT PUBLIK ME PROCEDURË TË HAPUR ME OBJEKT: “DHËNIA E TË DREJTAVE TË PËRDORIMIT NË BREZIN E FREKUENCAVE 800 MHZ (792-862 MHZ)”, REF. 1X10 MHZ I ÇIFTUAR-800-2018 .

Këshilli Drejtues (**KD**) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (**AKEP**), i përbërë nga:

- | | | |
|-----------------|----------|---------|
| 1. Z. Ilir | Zela | Kryetar |
| 2. Z. Alban | Karapici | Anëtar |
| 3. Znj. Edlira | Dvorani | Anëtar |
| 4. Znj. Ketrin | Topçiu | Anëtar |
| 5. Znj. Klarina | Allushi | Anëtar |

dhe sekretare e Këshillit Drejtues Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 05.07.2018, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin Nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin Nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, dhe Rregullores së Brendshme të Funksionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin Nr.7 datë 16.02.2018 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

Miratimin e dokumentit të tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: “Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 MHz (792-862 MHz)”, Ref. 1x10 MHz i çiftuar-800-2018.

BAZA LIGJORE:

1. Pika 1, neni 69 i Ligjit Nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
2. Ligji Nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

3. Pika 2.3 Kreu II, e VKM-së Nr.1252 datë 10.09.2008 “Për miratimin e Rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës të përdorimit të frekuencave”, e ndryshuar.
4. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 277 datë 29.03.2017 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave”;
5. Rregullore e brendshme e funksionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin Nr.7 datë 16.02.2018 të KD të AKEP.
6. Urdhëri Nr.404 datë 28.06.2018 “Për zhvillimin e procedurës për konkurimin publik për dhënien të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 MHz (792-862 MHz)”, i ndryshuar.

KËSHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor si më poshtë:

- Shkresa Nr.7481/4 Prot. datë 22.06.2018 (Prot. i AKEP: 688/10, datë 25.06.2018) e Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë, “Përgjigje tuajës Nr. 688/7 Prot. datë 15.05.2018 “Dërgojmë propozimin për procedurën e dhënies së të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 MHz (792-862 MHz)”;
- Dokumentat e hartuar nga Njësia e Hartimit të dokumentave së bashku me relacionin përkatës;
- Projektvendim i KD i formatuar dhe arsyetuar;

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

VËREN:

- Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën Nr. 7481/4 Prot. datë 22.06.2018 ka miratuar kufizimet dhe procedurën për dhënien e të drejtave të përdorimit të frekuencave në brezin 800 MHz (792-862 MHz) si më poshtë:
1. AKEP të vijojë procedurën e konkurrimit publik për dhënien e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 790-862 MHz, sipas ndarjes së propozuar:
 - Spektri i disponueshëm 2x30 MHz, me një Gap dulpeks prej 11 MHz.
 - Madhësia e bllokut 5 MHz i çiftuar.
 - Guard band prej 1 MHz me fillim 790 MHz.
 - FDD downlink fillon në 790 MHz dhe FDD uplink fillon në 832 MHz.
 2. Të ndiqet procedura e përcaktuar në VKM nr. 1252 datë 10.09.2008, i ndryshuar, “Procedurë e hapur” me raunde sipas skemës së propozuar.
 3. Numri maksimal i Autorizimeve Individuale për dhënien e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 790-862 MHz është 3 (tre), për të drejtë përdorimi bllok i çiftuar 10 MHz.

4. Vlera minimale e pranueshme për ofertuesit për dhënien e një autorizimi individual për përdorimin e frekuencave në brezin 800 MHz për bllokun 10 MHz i çiftuar, të jetë jo më pak se **7,440,000** (shtatë milion e katërqind e dyzet mijë) Euro.
5. Kohëzgjatja e vlefshmërisë së Autorizimit Individual të jetë 15 (pesëmbëdhjetë) vjet. Koha e fillimit të shfrytëzimit të frekuencave të jetë jo më vonë se dy muaj nga data e pajisjes me Autorizim Individual.
6. Për kushtet teknike për Autorizimin Individual të aplikohen përcaktimet e Planit Kombëtar të Frekuencave.
7. Kriter i vlerësimit të ofertave të vlefshme, të jetë çmimi i ofertës sipas formulës së mëposhtme:

$$Pox = 100 \times \frac{Çox}{Çomax}$$

Ku: Pox - [Pikët e një oferte të dhënë (x) në varësi të çmimit të ofertës]

Çox - [Çmimi i ofertës së dhënë]

Çomax - [Çmimi maksimal i ofertave]

8. Mënyra e pagesës: Pagesë e plotë në momentin e dhënies së autorizimit individual.
 - Dokumentacioni “Për miratimin e dokumentit të Tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: “Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 MHz (792-862 MHz)”, Ref. 1x10 MHz i çiftuar-800-2018”, është përgatitur në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës.

PËR KËTO ARSYE:

Duke marrë në konsideratë:

- Dokumentin e Tenderit;
- Shkresën Nr. 7481/4 Prot. datë 22.06.2018 të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë: “Përgjigje tuajës Nr. 688/7 Prot. datë 15.05.2018 “Dërgojmë propozimin për procedurën e dhënies së të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 MHz (792-862 MHz)”;
- Urdhërin Nr.404 datë 28.06.2018 “Për zhvillimin e procedurës për konkurimin publik për dhënien të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 MHz (792-862 MHz)”, i ndryshuar.

VENDOS:

1. Të miratojë Dokumentin e Tenderit publik me “Procedurë të Hapur” me objekt: “Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 MHz (792-862 MHz), Ref. 1x10 MHz i çiftuar-800-2018”, sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Njoftimi për Tender të botohet dy herë në Gazetat Kombëtare dhe një herë në Gazetat Ndërkombëtare.
3. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit www.akep.al.

4. Ngarkohet njësia e hartimit të dokumenteve të ndjekë procedurën për sa parashikohet në këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

KRYETAR

Iir ZELA

ANËTARË:

1. Alban KARAPICI
2. Edlira DVORANI
3. Ketrin TOPÇIU
4. Klarina ALLUSHI